



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.87/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çocaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, të parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Komuna Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 03.10.2025, merr këtë :

**V E N D I M**

**I. PRANOHET E BAZUAR** ankesa e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, ZL.Anr.87/2025 datë 30.09.2025.

**II.** Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 800 (tetëqind) €uro.

**III. DETYROHET** Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**IV. URDHËROHET** Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë bilbordin-banerin të vendosur mbi urën në rrugën Mitrovice Veriut-Leposaviq, posterat dhe materialin zgjedhor në Soçanicë sheshin qendror dhe Shtëpinë e Kulturës, në komunën e Leposaviqit, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sankzionohet me dënlime shtesë nga PZAP-i.

**A r s y e t i m**

Me datë 30.09.2025, ne PZAP, është parashtruar ankesën e identifikuara me numër ZL.Anr.87/2025, nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me datë 30.9.2025, gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve të subjekteve të tjera politikë, vunë re se përkrahësit e subjektit politik Srpska Lista në territorin e komunës së Leposaviqit, në vendbanimin Soçanicë, ngjiten

afishe në një vend të paautorizuar, konkretisht në një urë varëse në rrugën Mitrovica Veriut - Leposaviq, si dhe në vetë Soçanicë, pushtuan sheshin qendror dhe Shtëpinë e Kulturës duke ngjitur imazhe të tyre, gjë që është në kundërshtim me kodekset ligjore të subjekteve politike për përdorimin e objekteve për promovim dhe shkelin rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se ngjitet afishe në vende ku nuk parashihet për këtë qëllim. Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që lidhen me ciklin zgjedhor dhe rregullat, duke qenë se shkelja është kryer me 30.09.2025 në orën 13:00, ne kërkojmë nga PZAP-i të pranojë ankesën si të bazuar, të miratojë një vendim me të cilin ndëshkohet subjekti politik Srpska Lista - Zlatan Elek në përputhje me normat ligjore dhe rregullat që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

Si dëshmi ka bashkangjitur fotografitë e urës së mbuluar me bilbord të Srpska Liste në komunën e Leposaviqit, për vendbanimin Soçanicë, si dhe fotografitë nga sheshi qendror dhe Shtëpia e Kulturës në Soçanicë.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lista Serbe thekson se si dëshmi të pohimeve të tyre, ata kanë përpjekur të bashkëngjisnin fotografi, dhe kështu kanë manipuluar ato në ndonjë program për përpunimin e fotove, siç është fotografia numër 1, mbi të cilën kanë manipuluar qartë dhe me vetëdije fotografinë në mënyrë të tillë që të duket sikur materiali promovues fsheh shenjën e trafikut. Më saktë, shenjën e trafikut e kanë hequr duke e përpunuuar fotografinë. Në tekstin e mëtejmë, ne bashkëngjisim fotografinë numër 2, mbi të cilën shihet qartë se shenja e trafikut nuk është e mbuluar.

Më tej në përgjigje në ankesë theksohet se me këtë, Nenad Rašić ka manipuluar me vetëdije dhe në kundërshtim me rregullat fotografinë me qëllim që të mashtrojë gjyqtarët e nderuar të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe t'i shkaktojë dëm subjektit tonë politik. Po ashtu, Nenad Rašić dërgoi një fotografi nga Soçanica, komuna e Leposaviçit, për të cilën pohon se është bërë në sheshin qendror dhe se me këtë është shkelur Rregullorja Zgjedhore, megjithëse në vetë Rregulloren Zgjedhore neni 7, paragrafi 2, nuk përmend askund se është e ndaluar vendosja e materialit promovues në një mur mbështetës. Me këtë, ai përsëri ka përpjekur përmes manipulimit të mashtrojë gjyqtarët e nderuar të PZAP-it dhe t'i çojë në mashtrim, duke e njollosur kështu emrin e subjektit tonë politik. Fotoja e tretë është gjithashtu mashtrim. Nenad Rašić ka deklaruar se fotografia e diskutueshme është realizuar me 30.09.2025 në dritaren e Shtëpisë së Kulturës. Ne dëshirojmë të theksojmë se këtu bëhet fjalë për mashtrim nga z. Rašić, dhe se kjo fotografi është realizuar me 28.09., kur Lista Serbe pati mitingun e saj para-zgjedhor, i cili u njoftu në mënyrë të rregullt nga ZKZ Leposaviç, dhe se menjëherë pas përfundimit të mitingut, ajo hoqi të gjithë materialin zgjedhor, prandaj ne me përgjegjësi pohojmë se aktivistët e Nenad Rašićit nuk mund ta kenë bërë këtë fotografi dy ditë më vonë, por qëllimi po mashtrojnë gjyqtarët e nderuar të PZAP-it.

Si dëshmi, ne dërgojmë gjithashtu edhe fotografinë numër 4, të realizuar me 28.09.2025 në orën 19:30, mbi të cilën shihet qartë se në atë vend nuk ekziston material, as nuk mund të jetë fotografuar dy ditë pas mitingut tonë para-zgjedhor, dhe vetë Rašić nuk ka bashkangjitur dëshmi për kohën e krijimit të fotografisë së përmendor. Pohimet e Nenad Rašićit janë të lehta për t'u verifikuar dhe ne kemi vërtetuar këtë me fotografi.

Të njëjtë propozojnë që PZAP të miratojë përgjigjen ndaj ankesës si të bazuar, të refuzojë ankesën e parashtruar nga Nenad Rašić sepse është e pabazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës, dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

**-Ankesa është e bazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, janë të qëndrueshme dhe të bazuara, dhe si të tilla i aprovoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik Lista Serbe, për faktin se në territorin e komunës së Leposaviqit, në vendbanimin Soçanicë, ngjitet billbord-banerë të kandidatit për kryetar të komunës së Leposaviqit Zoran Todiq nga subjekti politik Lista Serbe në një vend të paautorizuar, konkretisht në një urë në rrugën Mitrovica Veriut-Leposaviq, si dhe në vetë Soçanicë, vendosën posterat dhe materialin zgjedhor në sheshin qendror të subjektit politik Lista Sérbe me numër 170 duke ngjitur imazhe të tyre dhe duke bërë thirrje qytetarëve për votimin e subjektit politik për procesin zgjedhor për zgjedhjet lokale që do të mbahet me datë 12 tetor 2025, ku me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se *"Veprimet e ndaluara të Subjekteve Politike...Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve."*

Subjekti Politik, Lista Serbe në përgjigje në ankesë ka kundërshtuar ankesën e parashtruesit të ankesës duke theksuar se bilbordi-baneri i vendosur mbi urë nuk e ka mbuluar shenjën e komunikacionit dhe fotografat të vendosura në sheshin qendror nuk përmendet askund se është e ndaluar vendosja e materialit promovues në një mur mbështetës, ndërsa se fotografia e vendosur në dritaren e Shtëpisë së Kulturës kjo fotografi është realizuar me 28.09.2025 kur Lista Serbe pati mitingun e saj para-zgjedhor, dhe se menjëherë pas përfundimit të mitingut, ajo hoqi.

Paneli duke vlerësuar pretendimet ankimore, provat e bashkangjitura si dhe per gjigjen ne ankesë ka gjetur se nuk ishte kontestuese se subjekti politik Lista Serbe ne kundërshtim me dispozitën ligjore te nenit 34 paragraf 1 nenparagraf 1.2 te LZP-se ka vendosur ne vende te paautorizuar posterat dhe materialin zgjedhor, konkretisht në një urë në rrugën Mitrovica Veriut-Leposaviq, një gjë e tille është e ndaluar sipas dispozitës se lartcekur pavarësisht a është mbuluar shenja e trafikut apo jo, konsiderohet se shkelja ka ndodhur me vet faktin e vendosjes se banerit ne rruge publike, e po ashtu edhe në sheshin qendror ne Soçanicë, , ndërsa sipas vlerësimit te panelit sa i përket vendosjes se materialit zgjedhor ne shtëpinë e kulturës ne Soqanice, pasi qe subjekti politik Lista Serbe kishte ofruar prova se materiali zgjedhor është hequr menjëherë pas mbajtjes se mitingut zgjedhor, vleresohet se ky subjekt ka ndërmarr veprime për te sanuar shkeljen e ndodhur.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjälë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor. Po ashtu, Subjekti Politik, Lista Serbe, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore, prandaj vendosja e posterëve-

njoftimeve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në objekte publike gjegjësish në objekte banesore kolektive në Mitrovicën e Veriut, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe të njëjtë shkelje janë sanksionuar me nenin 34 par.1 nën par.1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë për bazë praktikën e PZAP-it, e cila ka vendosur për rastet të ngjashme të fjalëve dhe të veprimeve të tilla të përdorura gjatë fushatës zgjedhore nga ana e Subjekteve Politike, dhe atë vendimin ZL Anr.75/2025 datë 01.10.2025, në të cilin vendim të PZAP-it, i është shqiptuar gjoba subjektit politik Lista Serbe për arsy se subjektit politik në fjalë, ka kryer shkelje të natyrës së tillë me çka i njëjti ka përsëritur shkelje të ngjashme.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në të cilin nen në mënyrë thuhet se “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektit politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Paneli vlerëson se në rastin konkret Lista Serbe, urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterat e vendosur në objekte ku kanë qenë të vendosura ato, ndërsa dështimi për t'iu bindur këtij urdheri nga PZAP-it, brenda periudhës së përmendor në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dëname shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, nenin 118 paragrafi 1, dhe nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, dhe paragrafi 2, të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.87/2025 më datën 03.10.2025



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.